

## **Abstrakt**

Sot në botën e biznesit njëra ndër çështjet më kryesore dhe më të rëndësishme është transparenca dhe besueshmëria e firmave me klientët e saj. Që të arrihen rezultate apo vlera të knaqshme firmat duhet fillimisht jenë të përbëra nga subjektet vendimmarrëse dhe stafit profesional dhe korrekt të cilët angazhohen dhe punojnë vazhdimisht në pajtueshmëri me Parimet e Kontabilitetit të Pranuara Përgjithësisht (GAAP).

Ndër ta rol mjaft të rëndësishëm këtë rast zënë auditorët. Ashtu sikur auditorët e brendshëm që janë të angazhuar nga vetë meaxhmenti i firmave, kemi edhe auditoret e jashtëm të cilët kryejnë funksione siç janë: kontrollimin e blerjeve dhe shitjeve, kontrollimin e librave të kontabilitetit, rishikimin listave të pagave, përpilimin e raporteve të ndryshme etj. Auditorët e jashtëm pra, na paraqiten si agjent të pavarur të angazhuar nga jashtë të cilët japin opinione mbi përmirësimin e firmës dhe aktivitetit brenda saj, dhe si rezultat i tyre arrihet evidentimi i mangësive financiare brenda saj, parandalimi i humbjeve të ardhshme si dhe parashikimi i rrisqeve të kushtueshme dhe të mundshme të cilat nuk do ishin profitabile për to.

Ky punim mundëson dhe ofron kuptimin procesit të auditimit të jashtëm, rolin dhe funksionin e auditorit të jashtëm në firma me theks të veçantë në raportimin financiar dhe në përmirësimin e vlerës së firmës.